



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2025:013868

Datë: 28.01.2025

Numri i dokumentit: 06769760

P.nr.35/25

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.A., me vendbanim në fshatin ... komuna e Vushtrrisë rr. "...", për shkak të veprës penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.565/24, e datës 24.01.2025, më datë 28.01.2025 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë themelore në Mitrovicë PP.II.565/24, e datës 24.01.2025 andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

### URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI: Sh.A., nga i ati A., e ëma H., e vajzërisë M, data e lindjes..., në Vushtri me vendbanim në rrugën "...", fshati ..., Komuna Vushtrri, i martuar, ka të kryer shkollën e lartë, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë 21.10.2023, në rrugën "...", fshati ..., Komuna Vushtrri, saktësisht në shtëpinë e tij, i pandehuri me dashje me anë të lidhjes direkt në rrjetin elektrik ka siguruar shërbime të rrymës për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit duke shmangur pagesën për këto shërbime, në atë mënyrë që i ka hekur daljet e njehsorit nga vendi i vet dhe i ka kyçur direkt në hyrje të njehsorit në L1, L2, L3, duke bërë kryqëzime të pikave bashkë, duke furnizuar tërë objektin pa matje, me të cilat veprime të dëmtuarës KEDS i ka shkaktuar dëm material në shumën totale prej 543.28€.

- Me këtë ka kryer veprën penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par.1 të KPRKsë

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 69, 70, dhe nenit 314 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 449 dhe 495 të KPPK-së, e

# G J Y K O N

Numri i lëndës: 2025:013868  
Datë: 28.01.2025  
Numri i dokumentit: 06769760

DËNIM ME GJOBË në shumën prej treqind euro (300 €), i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të dëmit të i'a paguaj të dëmtuarës KEDS shumën prej pesëqind e dyzetë e tri euro e njëzetë e tetë cent (543.28) euro.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej njëzetë (20) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP.II.nr.565/24, e datës 24.01.2025, kundër të pandehurit Sh.A., me vendbanim në fshatin ... komuna e Vushtrrisë rr. "...", për shkak të veprës penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par.1 të KPRK -së.

Gjykatës i'u është kërkuar që kundër të akuzuarit të jep Urdhër Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me besueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë së shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri Sh.A., ligjvënësi ka paraparë dënim me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që morri vendim që ta pranojë kërkesën për dhënie e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës: procesverbali me numër 2108152, i datës 21.10.2023, fatura me numër DMIHP2320805, e datës 06.11.2023, kalkulimi i rikthimit të humbjeve me numër të ID të rastit 495350, i datës 06.11.2023, fotoalbumi në shtojcë prej 6 fotografive, procesverbali për intervistimin e të pandehurit Sh.A. në SP-Vushtrri, i datës 24.09.2024 dhe duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprës penale *Vjedhja e shërbimeve* nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2025:013868

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasysh rrethanat si: shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, vepra këto të cilat janë në rritje e sipër, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”*.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal P.nr.35/25,  
datë 28.01.2025

GJYQTARI

Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.